

William R. Hite, Jr., Ed.D.
Mbikëqyrësi

12 prill 2021

Të dashur prindër dhe familje të Rajonit Shkollor të Filadelfias,

E dimë se ky vit ka qenë i mbushur me shumë pasiguri për familjet tona prandaj duam të ndajmë me ju disa informacione të rëndësishme për atë çka mund të prisni për pjesën e mbetur të vitit shkollor.

Plani i mësimi hibrid, shpaloja e fazës së III-të

Për fazën III, nxënësit në grupet e mëposhtme do të kenë mundësi të zgjedhin modelin e mësimi hibrid, duke filluar nga e hëna e javës së 10 majit 2021:

- të gjithë nxënësit e klasave 6-9 të cilët nuk janë kthyer ende, dhe
- nxënësit me nevoja komplekse në klasat 10-12.

“Pyetëtori për zgjedhjen e modelit të mësimi për fazën III” do të hapet të martën, me 20 prill, dhe do të mbyllet të martën, me 27 prill. Familjet e fazës III do të marrin një email me udhëzime se si të regjistrohen. Në qoftë se zgjidhni mësimin hibrid, fëmijës suaj do t’i caktohet një orar gjatë të cilit do të shkojë në shkollë personalisht dy ditë në javë dhe do të angazhohet në mësim dixhital tri ditë në çdo javë, duke filluar nga e hëna e 10 majit 2021. Për t’u përgatitur për mirëseardhjen e nxënësve, i gjithë stafi do të kthehet në ndërtesat e shkollës të hënën me 26 prill. Federata e Mësuesve të Filadelfias do të përfundojë rishikimet e gatishmërisë për të gjitha ndërtesat e mbetura shkollore përpara se të kthehet stafi. Për më shumë hollësi, ju lutemi vizitoni philasd.org/aes.

Faza III do të jetë shpaloja përfundimtare e planit tonë të mësimi hibrid për këtë vit shkollor. Nxënësit që nuk përfshihen në fazën III do të vazhdojnë me 100% mësim dixhital për pjesën e mbetur të vitit shkollor.

Diplomimi nga shkolla e mesme dhe festa të tjera të fundvitit

Ne e dimë se distancimi nga shokët, shoqet dhe mësuesit e shkollës ka qenë veçanërisht i vështirë për maturantët tanë të cilët patën përfytyruar një vit mature krejt ndryshe të shkollës së mesme. Megjithëse asgjë nuk mund ta kompensojë përvojën e vitit të sapokaluar, jemi të kënaqur të njoftojmë se:

- do të mund ta festoni të sigurt ceremoninë e diplomimit të shkollës së mesme me shokët, shoqet dhe familjen tuaj (sipas kufizimeve të sigurisë të lejuara për kapacitetin) në një vend fizik në mjedis jashtë, për sa kohë që kushtet e COVID-19-ës lejojnë grumbullimin e sigurt të shkollave, dhe
- si dhuratë të veçantë, Rajoni Shkollor do të ofrojë uniforma dhe kapele falas për maturantët që do të diplomohen në klasën e vitit 2021. Në qoftë se keni paguar për

uniformën dhe kapelen e fëmijës suaj, ne do t'ju kompensojmë për to. Shkollat do të ndajnë me ju më shumë hollësi kur procesi të jetë përfunduar.

Drejtorët e shkollave me klasa tranzicionale do të kenë fleksibilitetin që të mbajnë ceremoni të sigurta për kalimin nga njëra klasë në tjetrën. Ngjarje të tjera të fundvitit mund të koordinohen nga ekipi drejtues i çdo shkolle.


Të gjitha aktivitetet e fundvitit do të bëhen në mjedis jashtë dhe do të ndjekin në mënyrë të rreptë udhëzimet e sigurisë të përcaktuara nga Departamenti i Shëndetit Publik të Filadelfias, duke përfshirë: vënien universale të maskave, vetëkontrollin e pjesëmarrësve para ngjarjes, dhe distancimin social.

Mundësi për përparim dhe mësim personalisht gjatë verës

Ne po i ofrojmë gjithashtu nxënësve të të gjitha moshave dhe niveleve të klasave mundësinë që të lidhen me moshatarët e tyre duke ofruar këtë verë një meny të zgjeruar programesh përparimi dhe mësimi personalisht. Ka diçka për të gjithë. Hollësitë për këto programe dhe si ta regjistroni fëmijën tuaj do t'ju dërgohen ose mund t'i gjeni ato [këtu](#).

Shpresoj që ky informacion ju ndihmon që të planifikoni paraprakisht për pjesën e mbetur të vitit shkollor dhe ju jep diçka të cilën e prisni me dëshirë në javët dhe muajt e ardhshëm. Faleminderit që vazhdoni të jeni partnerë të rëndësishëm në arsimimin e fëmijës suaj.

Sinqerisht,



William R. Hite Jr., Ed.D.
Mbikëqyrësi
Rajoni Shkollor i Filadelfias